



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 6885 prot.

Roskovec, më 15.08.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 46, datë 15.08.2025

PËR

**KALIMIN E PASURISË SHTETËRORE NË PRONËSI NGA BASHKIA ROSKOVEC
TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT NË FUNKSION TË
POSTËS SË POLICISË ROSKOVEC**

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 3, 8, 9 pika 1.2, 18 dhe 54 shkronja “e” të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; të neneve 5 dhe 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; Ligjit nr.108/2014 “Për policinë e shtetit” i ndryshuar, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 459, datë 26.7.2018 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec, të pronës me emërtimin “Posta e Policisë Roskovec” dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 455, datë 10.7.2024 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të Bllokut nr. 3, në qendër të qytetit të Roskovecit (Faza 1)”, Bashkia Roskovec”; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec me nr. 64, datë 17.08.2018 “Për kryerjen e procedurave të shpronësimit për projektin “Rehabilitim i bllokut Urban nr.2 Roskovec”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.35 datë 13.06.2016 “Për miratimin e projektit të investimit me objekt “Rehabilitimi urban i tre blloqeve në Bashkinë Roskovec”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.68 datë 26.09.2017 “Për miratimin e projektit me objekt “Për rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr.2 Qendra e qytetit Roskovec”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 91, datë 31.10.2023 “Për miratimin e projektit “Rehabilitimi urban i një pjesë të bllokut nr. 3 në qendër të qytetit Roskovec (Faza 1)”; Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 20.07.2017 ndërmjet Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe Bashkisë Roskovec “Për dakordësinë institucionale midis dy institucioneve, DVP Fier dhe Bashkisë Roskovec “Mbi përcaktimin e objektit që do të shërbejë për sistemimin e SP Roskovec, deri në përfundimin e investimit”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec nr. 47,

datë 31.07.2024 “Për miratimin në parim dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për lidhjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit “Për ndërtimin e Postës së Policisë Roskovec” “; si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (nr 7213/2 prot, datë 07.08.2024) dhe Bashkisë Roskovec (nr 6241 prot, datë 07.08.2024) me objekt: “Për Ndërtimin e Postës së Policisë Roskovec”,

JU PARAQESIM PËR DISKUTIM DHE MIRATIM:

1. Të miratohet kalimi i sipërfaqes së tokës sipas planvendosjes bashkëngjitur nga Bashkia Roskovec në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për qëllime institucionale dhe të shërbimit të rendit publik, në funksion të objektit të ndërtuar “Posta e Policisë Roskovec”, konkretisht 2112 m² nga e cila 1510 m² në pasurinë me nr.352/21, zona kadastrale 3196, kodi unik 3196025128 dhe 602 m² në pasurinë me nr.352/23, zona kadastrale 3196, kodi unik 3196025130.
2. Sipërfaqja e tokës e përcaktuar në pikën 1, hiqet nga sipërfaqja e pronave të paluajtshme që ka në pronësi bashkia sipas Certifikatave të Pronësisë lëshuar nga ASHK bashkëngjitur.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Roskovec për zbatimin e këtij vendimi dhe për ndjekjen e procedurave të mëtejshme në bashkëpunim me institucionet qendrore përkatëse.

Konceptoi: *V.Zeqo*

E.Hoxha

Konfirmoi: *D.Hoxha*

KRYETARI

Majlinda Bufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 688/1 prot.

Roskovec, më 15.08.2025

Lënda: Relacion për projektvendimin “Për miratimin e kalimit të pasurisë shtetërore në pronësi nga Bashkia Roskovec te Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në funksion të Postës së Policisë Roskovec”.

KËSHILLIT BASHKIAK

Roskovec

Të nderuar anëtar/anëtare të Këshillit Bashkiak!

Në funksion të bashkëpunimit ndërinstitucional për garantimin e funksioneve publike, paraqitet ky relacion në lidhje me propozimin për kalimin në pronësi të sipërfaqes përkatëse në pasuritë shtetërore nga Bashkia Roskovec te Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Ky projektvendim vjen si vijim i gjithë bashkëpunimit që Bashkia Roskovec ka pasur me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për zbatimin e planit të detajuar vendor të bashkisë miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.35, datë 13.06.2016 “Për miratimin e projektit të investimit me objekt “Rehabilitimi urban i tre blloqeve në Bashkinë Roskovec“. Ky plan kishte të përcaktuar që Posta e Policisë do të transferohej nga vendndodhja e mëparëshme (e cila ndodhej pranë godinës së vjetër të bashkisë) në vendndodhjen aktuale që është ndërtuar në Bllokun nr.3.

Për këtë, gjatë zbatimit të projektit të Rehabilitimit të bllokut nr. 2, sipas kërkesës sonë është bërë transferimi i pronës së Policisë nga Ministria e Brendshme në pronësi të Bashkisë Roskovec, e cila më pas vijoi me prishjen e godinës dhe realizimin e projektit. Prona është transferuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 459, datë 26.7.2018 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec, të pronës me emërtimin “Posta e Policisë Roskovec” dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar”.

Në përmbushje të detyrimeve tona si palë Bashkia Roskovec ka bërë një Marrëveshje me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier për transferimin përkohësisht të policisë në godinën pranë spitalit deri në ndërtimin e Stacionit të ri të Policisë Roskovec, Marrëveshje bashkëpunimi datë 20.07.2017 ndërmjet

Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe Bashkisë Roskovec “Për dakordësinë institucionale midis dy institucioneve, DVP Fier dhe Bashkisë Roskovec “Mbi përcaktimin e objektit që do të shërbejë për sistemimin e SP Roskovec, deri në përfundimin e investimit” “.

Në muajin Tetor të vitit 2023 është miratuar nga ana juaj VKB Nr. 91, datë 31.10.2023 “Për miratimin e projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3 , në qendër të Qytetit Roskovec (Faza 1)”.

Ky projekt përmban këto nënobjekte:

1. Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare
2. Ndërtimi i parkut të ri të qytetit
3. Sistemimi i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të
4. Ndërtimi i Postës së re të Policisë Roskovec

Në funksion të interesit publik, pas ndjekjes së procedurave të shpronësimit, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 455, datë 10.07.2024 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3 , në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)”, Bashkia Roskovec”, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë Nr. 119, Datë 12.07.2024.

Për zbatimin e VKM nr.455, datë 10.07.2024, Bashkia Roskovec në bashkëpunim me ASHK Fier ka vijuar me fillimin e procedurave për hedhjen e gjurmës në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit, përfaqësuar nga Bashkia Roskovec.

Projekti “Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3, në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)” përmban katër nënobjekte e sipërcituara, ku përfshihet dhe nënobjekti “Ndërtimi i Postës së re të Policisë Roskovec”.

Ndërtimi i Postës së re të Policisë është bërë në pasuritë nr. 352/13 dhe nr 352/18 zk. 3196, pasuri të shpronësuara me VKM nr. 455, datë 10.07.2024 dhe pas kryerjes së procedurës nga ASHK Fier, këto dy pasuri kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec. Konkretisht,

- Bashkia Roskovec është pronare me certifikatë pronësie lëshuar datë 22.07.2024 nga ASHK Fier, e pasurisë nr. 352/21 zk 3196, e cila vjen si ndarje e pasurisë mëmë nr. 352/13 zk 3196 të shpronësuar vetëm për sipërfaqen 2675 m² me VKM nr. 455, datë 10.07.2024.
- Bashkia Roskovec është pronare me certifikatë pronësie lëshuar datë 22.07.2024 nga ASHK Fier, e pasurisë nr. 352/23 zk 3196, e cila vjen si ndarje e pasurisë mëmë nr. 352/18 zk 3196 të shpronësuar vetëm për sipërfaqen 1286 m² me VKM nr. 455, datë 10.07.2024.

Me miratimin e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec nr. 47, datë 31.07.2024 “Për miratimin në parim dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për lidhjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit “Për ndërtimin e Postës së Policisë Roskovec” “; si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (nr 7213/2 prot, datë 07.08.2024) dhe Bashkisë Roskovec (nr 6241 prot, datë 07.08.2024) me objekt: “Për Ndërtimin e Postës së Policisë Roskovec”, Bashkia Roskovec vijoi me apikimin për leje ndërtimi në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke lejuar që Posta e re e Policisë të

ndërtohet në pasuritë pronë e Bashkisë Roskovec, duke përmbushur kështu qëllimin për të cilin janë shpronësuar këto prona.

Financimi i objektit u realizua nga të ardhurat e vetë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Objekti është në funksion të realizimit të misionit të Policisë së Shtetit për ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut për banorët e bashkisë Roskovec.

Posta e re e Policisë Roskovec është ndërtuar në bllokun nr. 3, sipas planit urbanistik të tre blloqeve urbane si edhe Planit të Përgjithshëm Vendor.

Sipërfaqja që ka zënë ndërtimi dhe funksionimi i Postës së re të Policisë është aktualisht në total 2112 m² sipas planvendosjes bashkëngjitur. Konkretisht, prek 1510 m² në pasurinë nr.352/21 dhe 602 m² në pasurinë nr.352/23.

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur midis Bashkisë Roskovec dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Policisë së Shtetit konkretisht në nenin 4 “Angazhimet, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve është përcaktuar se Bashkia do të vërë në dispozicion një sipërfaqe toke në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Kjo sipërfaqe është e përcaktuar qartë në marrëveshjen ndërinstytucionale dhe shërben për:

- Ndërtimin e objektit të ri të Postës së Policisë në territorin e bashkisë;
- Funksionimin institucional të strukturave të Policisë së Shtetit në territorin e bashkisë.

Marrëveshja ka ardhur si rezultat i një procesi shpronësimi të mëparshëm, ku Drejtoria e Policisë ka humbur të drejtën e përdorimit mbi një pasuri tjetër dhe Bashkia është angazhuar të japë një sipërfaqe të re në kompensim dhe bashkëpunim.

Duke marrë parasysh interesin publik të mbrojtjes së rendit dhe sigurisë, si dhe marrëveshjen ekzistuese ndërmjet palëve, propozohet që Këshilli Bashkiak të miratojë kalimin e kësaj sipërfaqeje toke në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që të vijohet me transferimin e pasurisë nga pronësia e bashkisë Roskovec në favor të Policisë së Shtetit.

Në kuadër të këtij projektvendimi janë zhvilluar dy dëgjesa publike datë 11.08.2025 në bazë të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit Nr 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 18, si dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike.

Vendimmarrja që i kërkohet Këshillit të Bashkisë Roskovec, gjen mbështetje ligjore në nenin 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 3, 8, 9 pika 1.2, 18 dhe 54 shkronja “e” të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; të neneve 5 dhe 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; Ligjit nr.108/2014 “Për policinë e shtetit” i ndryshuar, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 459, datë 26.7.2018 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec, të pronës me emërtimin “Posta e Policisë Roskovec” dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 455, datë 10.7.2024 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të

paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të Bllokut nr. 3, në qendër të qytetit të Roskovecit (Faza 1)”, Bashkia Roskovec”; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec me nr. 64, datë 17.08.2018 “Për kryerjen e procedurave të shpronësimit për projektin “Rehabilitim i bllokut Urban nr.2 Roskovec”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.35 datë 13.06.2016 “Për miratimin e projektit të investimit me objekt “Rehabilitimi urban i tre blloqeve në Bashkinë Roskovec”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.68 datë 26.09.2017 “Për miratimin e projektit me objekt “Për rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr.2 Qendra e qytetit Roskovec”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 91, datë 31.10.2023 “Për miratimin e projektit “Rehabilitimi urban i një pjesë të bllokut nr. 3 në qendër të qytetit Roskovec (Faza 1)”; Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 20.07.2017 ndërmjet Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe Bashkisë Roskovec “Për dakordësinë institucionale midis dy institucioneve, DVP Fier dhe Bashkisë Roskovec “Mbi përcaktimin e objektit që do të shërbejë për sistemimin e SP Roskovec, deri në përfundimin e investimit”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec nr. 47, datë 31.07.2024 “Për miratimin në parim dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për lidhjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit “Për ndërtimin e Postës së Policisë Roskovec” “; si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (nr 7213/2 prot, datë 07.08.2024) dhe Bashkisë Roskovec (nr 6241 prot, datë 07.08.2024) me objekt: “Për Ndërtimin e Postës së Policisë Roskovec”.

Për sa më sipër, në përfundim, në mbështetje të dispozitave të sipërcituara i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Roskovec:

1. Të miratohet kalimi i sipërfaqes së tokës sipas planvendosjes bashkëngjitur nga Bashkia Roskovec në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për qëllime institucionale dhe të shërbimit të rendit publik, në funksion të objektit të ndërtuar “Posta e Policisë Roskovec”, konkretisht 2112 m² nga e cila 1510 m² në pasurinë me nr.352/21, zona kadastrale 3196, kodi unik 3196025128 dhe 602 m² në pasurinë me nr.352/23, zona kadastrale 3196, kodi unik 3196025130.
2. Sipërfaqja e tokës e përcaktuar në pikën 1, hiqet nga sipërfaqja e pronave të paluajtshme që ka në pronësi bashkia sipas Certifikatave të Pronësisë lëshuar nga ASHK bashkëngjitur.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Roskovec për zbatimin e këtij vendimi dhe për ndjekjen e procedurave të mëtejshme në bashkëpunim me institucionet qendrore përkatëse.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

Konceptoi: V.Zeqo

E.Hoxha

Konfirmoi: D.Hoxha

KRYETARI

Majlinda Buri